

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaBond® T-2

ADEZIV I FORTË, ELASTIK DHE ME REZISTENCË TË LARTË PËR NDËRTIMIN



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaBond® T-2 është adeziv me 1 përbërës, pa tretës, me ngjitje të mirë dhe me kapacitet shumë të lartë ngarkese.

PËRDORIMET

SikaBond® T-2 është krijuar për ngjitje në mjedise të jashtme dhe të brendshme të parvazeve të dritareve, shkallëve, blinduesve, pllakave të bazës, pllakave mbrojtëse kundër përplasjes, pllakave mbuluese, tabelave sinjalizuese dhe elementeve të parafabrikuara.

SikaBond® T-2 ngjitet mirë mbi beton, tulla, gurë, pllaka, qeramika, dru, alumini, çelik, suva, PVC të fortë, GFRP dhe PU.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ngjitje fillestare e fuqishme
- Fiksim pa shirita, gozhdë apo vida
- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënshtresa
- Kapacitet për ngarkesa të larta
- Shmang korrodimin galvanik
- Tharje e shpejtë
- Vetë elastike, amortizim i zhurmave
- Rezistent ndaj vibrimeve dhe tronditjes
- Rezistencë e lartë ndaj ndikimeve të motit
- Adezivi mund të smerilizohet
- Çlirime shumë të ulëta

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EMICODE EC1^{PLUS} R
- LEED® EQc 4.1
- SCAQMD, Rregulli 1168
- BAAQMD, Rreg. 8, Rregulli 51

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	poliuretan i teknologjisë <i>i-Cure</i>	
Ambalazhi	tubetë 300 ml (390 g), 12 tubeta/ kuti	
Ngjyra	e bardhë	
Jetëgjatësia	SikaBond® T-2 ka jetëgjatësi prej 12 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.	
Kushtet e magazinimit	SikaBond® T-2 duhet të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5 °C dhe +25 °C.	
Dendësia	1.30 kg/l	(ISO 1183-1)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~55 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~2.5 N/mm ²	(ISO 37)

Zgjatimi deri në thyerje	~ 400%	(ISO 37)
Rezistenca ndaj tërheqjes prerëse	~2.0 N/mm ² , 1 mm trashësi adezivi	(EN 14293)
Rezistenca kimike	SikaBond® T-2 ka rezistencë të përhershme ndaj ujit, shumicës së solucioneve dhe detergjenteve të pastrimit, ujit të detit, ujit të gëlqeres, acideve dhe finjës së dobët dhe ujërave të ndotur shtëpiakë. SikaBond® T-2 ka rezistencë të përkohshme ndaj mineraleve, vajrave dhe yndyrnave bimore dhe shtazore si dhe gjithashtu lëndëve djegëse. SikaBond® T-2 nuk ka ose ka rezistencë vetëm të përkohshme ndaj tretësve organik (ketone, estere, aromatike) dhe alkooleve, holluesve të llaçeve dhe bojërave, acideve dhe finjës së fortë. Për informacione specifike ju lutemi kontaktoni me shërbimin teknik Sika.	
Temperatura e funksionimit	-40 °C deri në +90 °C	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Aplikim me pika / formë "kordoni": ~ 44 ml për metër linear (me majë trekëndore)	
Varja	Shumë e ulët	(ISO 7930)
Temperatura e mjedisit	+5 °C deri në +35 °C, min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C deri në +40 °C	
Ritmi i maturimit	~3.5 mm/24 orë (23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP 049-2)
Koha e krijimit të kores	~40 minuta (23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP 019-1)

UDHËZIME APLIKIMI

Për aplikimin e SikaBond® T-2 duhet të zbatohen të gjitha udhëzimet standarde të ndërtimit.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vavra, graso, pluhur dhe grimca apo materiale të lira. Boja, korja e çimentos dhe kontaminues të tjerë duhet të hiqen. SikaBond® T-2 ndërkapet pa prajmer dhe/ose aktivizues. Megjithatë, për ndërkapje optimale dhe aplikime kritike me performancë të lartë, si p.sh. ndërtesat shumëkatëshe, fuga me sforcim të lartë, ekspozim në kushte ekstreme moti apo prani të përhershme uji, duhet të ndiqen procedurat e mëposhtme të lysterjes me prajmer dhe/ose trajtimit paraprak:

Nënshtresa joporoze

Alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i galvanizuar, metale të veshura me pluhur apo pllakat me glazurë duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht duke përdorur Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër. Pasi keni lënë kohë tharjeje prej > 15 minutash (< 6 orë), aplikoni Sika® Primer-3 N me furçë. Përpara ngjitjes, lejoni një kohë shtesë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë).

PVC duhet të lyhet me prajmerin Sika® Primer-215. Lejoni një kohë shtesë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë) përpara ngjitjes.

Nënshtresa poroze

Betoni, aerobetoni dhe suvatë me bazë çimentoje, llaçet dhe tullat duhet të lyhen me furçë me prajmerin Sika® Primer-3 N. Përpara izolimit, lejoni një kohë

tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë).

Për më tepër këshilla dhe informacione të detajuara ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

Shënim: Prajmerat përforcojnë ndërkapjen. Ato nuk zëvendësojnë pastrimin e duhur të nënshtresës dhe as nuk përmirësojnë ndjeshëm rezistencën e sipërfaqes.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Pas përgatitjes së nevojshme të nënshtresës, vendosni tubetën ose sallamin e izoluesit tek pistoletat dhe nxirrni SikaBond® T-2 brenda fugës duke u siguruar se është në kontakt të plotë me anët e fugës dhe nuk ka ajër të bllokuar. Aplikoni SikaBond® T-2 në kordona me formë trekëndore me lartësi ~ 10 mm dhe gjerësi ~ 8 mm me distancë disa centimetra nga secili. Nëse nevojitet, përdorni mallë krëhër për të përhapur SikaBond® T-2 në mënyrë të njëtrajtshme. Ngjeshni ose shtypni fort bashkë pjesët e ngjitura për të siguruar një ngjitje të mirë përpara krijimit të kores. Trashësia e rekomanduar e shtresës së adezivit (në varësi të rrafshësisë së sipërfaqes) është 1–5 mm. Adezivi i freskët dhe i patharë i mbetur në sipërfaqe duhet të hiqet menjëherë. Një element në pozicion të gabuar mund të shkëputet dhe të ripozicionohet gjatë minutave të para pas aplikimit.

Rezistenca përfundimtare mund të përftohet pas tharjes së plotë të SikaBond® T-2.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208 dhe/ose Sika® TopClean T. Pas tharjes materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Fleta e të dhënave të sigurisë
- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin & ngjitjen

KUFIZIME

- Për punueshmëri të mirë, temperatura e adezivit duhet të jetë $\geq +15$ °C.
- Për tharjen e duhur të adezivit, nevojitet lagështi e mjaftueshme ambientit.
- Duhet të kryhen prova për të testuar mundësinë për lyerje dhe kompatibilitetin e bojës. Kur SikaBond® T-2 do të vishet, duhet të testoni kompatibilitetin me secilën veshje/bojë.
- Mund të ndodhin ndryshime në ngjyrë për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta dhe/ose rrezatimit UV (sidomos në ngjyrën e bardhë). Megjithatë, ndryshimi i ngjyrës është i natyrës estetike dhe nuk ndikon negativisht mbi performancën teknike apo qëndrueshmërinë e produktit.
- Të mos përdoret mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon) dhe disa materiale sintetike të plastifikuara (kryeni prova paraprake ose kontaktoni me shërbimin teknik Sika).
- Përpara përdorimit të SikaBond® T-2 mbi gurin natyror, ju lutemi kontaktoni me shërbimin teknik Sika për këshilla.
- Mos ekspozoni SikaBond® T-2 e patharë ndaj produkteve me përmbajtje alkooli pasi mund të ndikojnë në reaksionin e tharjes.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaBond® T-2
Shkurt 2019, Botimi 01.01
020513010000000029

SikaBondT-2-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf